

William R. Hite, Jr., Ed.D.
Superintendent

22 Shkurt, 2021

Të dashur Familjarë të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Unë dua t'ju informoj se vazhdoj të besoj se jemi gati të fillojmë rihapjen e shkollave tona për mësim në - person, duke filluar nga 1 Mars me studentët Pre/K - 2 familjet e të cilëve zgjodhën mësimin hibrid .

Siç kam ndarë më parë, ne kemi punuar ngushtë me Spitalin e Fëmijëve të Filadelfias (CHOP) dhe Departamentin e Shëndetit Publik të Filadelfias për të marrë masa të gjëra për të mbrojtur këdo që hyn në shkollat tona. Planet tona përfshijnë:

1. Testim të Shpejtë për Studentët - Çdo javë, infermierët e shkollës do të administrojnë testimin e shpejtë për 20% të të gjithë studentëve që mësojnë në - person, si dhe studentëve që nuk janë në gjendje të mbajnë një maskë fytyre ose qëndrojnë të distancuar nga shoqëria për shkak të një gjendje shëndetësore ose paaftësie. Studentët që shfaqin simptoma të ngjashme me COVID gjatë ditës së shkollës do të testohen menjëherë. Mësoni më shumë rreth planit tonë të testimit të studentëve në philasd.org/studenthealth/covidtesting;
2. Testim i Shpejtë për Personelin - Të gjithë punonjësve në vend do t'u kërkohet të bëjnë një test COVID çdo javë kur të fillojë mësimi në - person;
3. Vaksinat COVID-19 për personelin - Të ndihmuar nga CHOP, ne tashmë po rezervojmë takime për personelin që punon me studentët të cilët zgjodhën të vaksinohen dhe vaksinimet fillojnë sot;
4. Masa të tjera të sigurisë - I gjithë personeli dhe studentët duhet të mbajnë maska ose mbulesë tjetër të fytyrës, e cila do të sigurohet për ta. Instalimet dhe sinjalistikat e reja në klasë do të promovojnë distancimin social. Vendet e pastrimit të duarve, vendet e materialeve të pastrimit, shenjat maksimale të përdorimit dhe protokollet e përmirësuara të pastrimit janë gjithashtu në vëndet e tyre.
5. Linjat telefonike - Prindërit me pyetje mund të na kontaktojnë ditët e javës nga ora 8 e mëngjesit - 4:30 pasdite në 215-400-5300 (anglisht) ose të gjejnë gjuhë të tjera [këtu](#); dhe

6. “ Open House” - turne janë në dispozicion sipas kërkesës për çdo shkollë që ne planifikojmë të rihapim. Thjesht kontaktoni shkollën e fëmijës tuaj për detaje.

Javën e kaluar, Drejtori i Laboratorit të Politikave të CHOP, Dr. David Rubin dëshmoi në një seancë mbledhjeje të këshillit të Qytetit në lidhje me [Shkencën e COVID dhe Të Mësuarit në Person](#), [Udhëzime të reja CDC për Rihapjen e Shkollave](#), [Ventilimin](#) dhe më shumë. Ai tha, “ Përfundimi që kemi arritur - përballë rënies së transmetimit, planeve të forta të sigurisë dhe shtimit të një programi të fortë të testimit të sigurimit - është se dritarja e mundësive është hapur për kthimin e më shumë fëmijëve në klasë ”

Shkenca është e qartë. Ne mund të rihapim në mënyrë të sigurtë shkollat tona, duke ndjekur shembullin e shumë prej rretheve shkollore më të mëdha të vendit. Ne do të vazhdojmë të kërkojmë gjuhë të përbashkët në procesin e ndërmjetësimit drejt këtij qëllimi.

Sinqerisht,



William R. Hite Jr., Ed.D.

Superintendent

Drejtoria Arsimore e Filadelfias